

1

REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA E KOSOVËS AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU KOSOVO COMPETITION AUTHORITY			
Nr. Prot./Br. Pro.	Prot.No.	59/19 - 02/D	
Nr. Faj/Br. St. in.	Pg.	1/5	
Data Datum/Date:	11.03.2019		
Prishtinë, Kosovë			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës  
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Nr.13/19  
Datë: 11 Mars 2019

Duke u bazuar në nenet 28,29,34,35 të Ligjit Nr.03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Plotësim Ndryshimi i tij, Ligji Nr. 04/L-226, Rregullorja Nr.01/2017 për Procedurat Hetimore të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2018, për Mënyrën dhe Kriteret e Përcaktimit të Tregut Përkatës, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, në mbledhjen e mbajtur më datë: **11 Mars 2019**, vendosi që të:

**REKOMANDOJË**

- I. Odën e Avokatëve, që të shfuqizojë Vendimin Nr.579/2018, lëshuar nga Këshilli Drejtues i Odës së Avokatëve të Kosovës, datë 10.04.2018, me të cilin kufizohet ofrimi i shërbimeve të avokatëve të regjionit, në Komunën e Mitrovicës.
- II. Oda e Avokatëve duhet, që të ofroj kushte të barabarta për transaksione të njëjta me operatorët tjerë ekonomik, duke i vendosur të njëjtët në gjendje të favorshme konkurruese përmes mekanizmave ligjorë, në respektim të ekonomisë së tregut me konkurrencë të lirë, të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës,

**Sepse**

- Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, vlerëson se në këtë rast kufizohet konkurrenca ndërmjet avokatëve si (ofruer të shërbimeve) në Republikën e Kosovës, ndërsa klientëve/konsumatorëve i'u imponohet zgjedhja e të njëjtëve brenda një zone të caktuar gjeografike, prandaj nga pikëpamja e konkurrencës, ligjet dhe rregulloret që kufizojnë numrin e operatorëve ekonomik në tregun relevant dhe kufizimin e marrjes së shërbimeve, nuk janë në përputhje me rregullat e konkurrencës.
- Gjithashtu, **Ligji Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, i cili përcakton qartë definicionin e ndërmarrjes, e rrjedhimisht edhe pozicionin e shtetit në raport me këtë definicion, citojmë: Ndërmarrje – është çdo aktivitet biznesor pavarësisht mënyrës së organizimit ose formës së menaxhimit, ndërmarrësi publike e themeluar për kryerjen e aktiviteteve për interes publik si dhe çdo person tjetër**

fizik ose juridik apo autoritet shtetëror që kryen aktivitet ekonomik pavarësisht se a konsiderohet apo jo subjekt afarist.

Andaj, lidhur me këtë Rekomandojmë Odën e Avokatëve që të shfuqizoj Vendimin Nr. 579/2018, lëshuar nga Këshilli Drejtues i Odës së Avokatëve të Kosovës, datë 10.04.2018, me qëllim shmangien e kufizimeve të konkurrencës në tregun e shërbimeve të avokatisë, si dhe dhënien e mundësisë, që të gjithë avokatët të kenë në angazhimin ex-officio.

## ARSYETIM

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës për vlerësimin ex post të Vendimit, Nr.579/2018, lëshuar nga Këshilli Drejtues i Odës së Avokatëve të Kosovës, datë 10.04.2018, është vënë në funksion pas ankesës së Avokates Kada Perquku me nr.prot.271/18-01/H datë 06.07.2018, e cila pretendon se me këtë Vendim me të cilin është aprovuar kërkesa e zyrës koordinuese, për ndarjen e listës së Mitrovicës dhe unifikimin me praktikën për angazhim të avokatëve sipas detyrës zyrtare në të gjithë Kosovën nga listat sipas komunave, rrjedhimisht me këtë Vendim, avokatët e Vushtrrisë dhe Skënderajit, i'u është mohuar e drejta që të përfaqësojnë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Departamentin e Krimeve të Rënda dhe Departamentin për të Mitur.

Gjithashtu pala pretendon se me këtë Vendim është bërë shkelje e të drejtës për barazi në punë ndërmjet avokatëve, sepse me këtë Vendim, vetëm avokatëve të Mitrovicës i'u mundësohet përfaqësimi sipas detyrës zyrtare në departamentet e lartëcekura edhe pse Gjykata e Themelore në Mitrovicë është gjykatë regjionale, që vepron edhe për komunën e Vushtrrisë dhe Skënderajit.

*Veprimtaria e avokatëve është rregulluar me Ligjin nr. 04/L-193 për Avokatinë citoj Neni 3,1. Avokatia është profesion i lirë dhe i pavarur që merret me dhënien e ndihmës juridike personave fizikë dhe juridikë për mbrojtjen e lirisë, të drejtave dhe të interesave të tyre në pajtim me rendin juridik.*

*Pra, Avokatët janë të licencuar që të kryejnë shërbimet për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, ndërsa për angazhimin sipas detyrës zyrtare ata paguhën sipas Vendimit 80/2014 me të cilin e miraton Udhëzimin Administrativ 9/2014 Për Procedurat Për Kompensimin e Mbrojtësve me Shpenzime Publike. në të cilin nuk është paraparë një kufizim i tillë, përveq në Nenin 7 të këtij udhëzimi, citojmë; "Kompensimi i avokatit mbrojtës me shpenzime publike nuk mund të tejkaloj shumën prej 500.00 € (Pesëqind euro) për një muaj duke përfshirë angazhimin e tyre në të gjitha Gjykatat e Kosovës".*

### Përcaktimi i Tregut Relevant

Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2018, Për Mënyrën dhe Kriteret e Përcaktimit të Tregut Përkatës,

- Tregu Gjeografik, është territori i Republikës së Kosovës.

- Tregu i Produktit, janë shërbimet e Avokatit sipas Ligjit për Avokatinë.

### **Kufizimi dhe Ndarja e Tregut**

Autoriteti, sugjeron se çdo kufizim ligjor apo faktik i numrit të operatorëve të cilët janë potencial për tu angazhuar në një veprimtari në një treg të caktuar (numerus clausus) është *i ndalueshëm dhe sanksionueshëm* me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, që konkurrentët /operatorët të mos kufizohen nëpërmjet kushteve dhe kriterëve, sepse për të pasur konkurrencë të mirëfilltë duhet që të ketë më shumë konkurrent në tregun relevant. Autoriteti konstaton se, me Vendimin Nr.579/2018 OAK, kufizon ose kontrollon prodhimin/shërbimin si dhe vendosjen e ofertës në pozita tejet komode në tregun përkatës, andaj konsumatorit me këtë kufizim i mohohet e drejta e zgjedhjes për marrjen shërbimeve tek operatorët ekonomik,që veprojnë në tregun përkatës gjeografik dhe të produktit/shërbimit.

Autoriteti është në zbatim të Ligjit Nr.03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, angazhohet për të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës (Abuzimit me Pozitën Dominuese, Marrëveshjeve të Ndaluar, Praktikave të Bashkërenduara dhe Realizimit të Përqendrimeve të Paligjshme) nga ndërmarrjet ekonomike private apo publike, por edhe nga kufizimet e shkaktuara nga **administrata shtetërore dhe entet rregullatorë** në territorin e Republikës së Kosovës ose jashtë saj, nëse këto veprime kanë efekte në Kosovë.

Mendimi profesional, është marrë nga Autoriteti ekskluzivisht nga këndvështrimi i rregullave që dalin nga Ligji Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, për një treg të hapur dhe konkurrues, duke u bazuar edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 10 “Ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës” gjithashtu duke u bazuar në nenin 23 “Dhënia e Mendimit Profesional” të Ligjit nr.03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, me ç’rast përmes këtij rekomandimi i propozon Odës së Avokatëve, që të ndërmarr veprime ligjore për caktimin e ex-officio të avokatëve.

### **Vlerësimi i Pasojave mbi Konkurrencën në Treg dhe Avokimi**

Bazuar në detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit të AKK-së sipas Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës neni 28 paragrafi 1 pika 1.7, 1.8 1.10 me të cilin Komisioni është i obliguar që në mënyrë aktive t’i promovojë njohurit për konkurrencën në treg, ngritjen e vetëdijësimit dhe përcakton rregullat dhe masat për mbrotjen e konkurrencës efektive në treg.

Legjislacioni i hartuar nga organet e administratës qendrore ose nga iniciues të pavarur, pa u konsultuar me Autoritetin e Konkurrencës, mund të ketë pasoja negative mbi konkurrencën në treg.

Zbatimi i hapave kryesor analitikë në vlerësimet legjislativ ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së propozimit si dhe ndihmon për të shpjeguar nevojshmërinë e një veprimi apo në të kundërt demonstroi që nuk duhet të ndërmerret një veprim i caktuar legjislativ.

Neni 23 i Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, e parasheh që organet e administratës qendrore dhe lokale, mund të kërkojnë vlerësimin apo mendimin profesional të Autoritetit për çdo ligj, projektligj ose akt-normativ që prek ndjeshëm konkurrencën në treg.



Vlerësimi *ex post* i ligjeve, akteve nënligjore, rrjedhimisht vendimeve ekzistuese është detyrë e Autoritetit dhe presupozon identifikimin e akteve normative në fuqi dhe analizën e pasojave mbi konkurrencën. Bashkëpunimi me rregullatorët sektorialë dhe autoritetet kompetente është i dëshirueshëm dhe në disa raste i domosdoshëm për kryerjen e këtij vlerësimi. Për vlerësimin e projekt-akteve normative, vlerësimi *ex ante*, është e domosdoshme që hartuesit e tyre të bashkëpunojnë dhe të marrin parasysh **sugjerimet dhe rekomandimet** e dhëna nga Autoriteti Kosovar i Konkurrencës.

### **Mbrojtja dhe nxitja e konkurrencës**

Sipas Kushtetutës së Kosovës, neni 10: *Ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës*. Si e tillë institucionet e shtetit e posaçërisht Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, është i obliguar ta zbatojë këtë dispozitë kushtetuese dhe Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Neni 119 paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcakton qartë se: *“Veprimet që kufizojnë konkurrencën e lirë përmes vendosjes ose abuzimit të pozitës dominuese, ose praktikave që e kufizojnë konkurrencën, janë të ndaluara, me përjashtim kur këto lejohen në mënyrë eksplicite me ligj”*.

Integrimi i Kosovës në BE dhe standardet që dalin nga Rregulloret e Komisionit Evropian (Neni 101 i TFEU-së) që kërkohen të arrihen në këtë proces është një tjetër faktor përcaktues dhe nxitës për fushën e konkurrencës.

Marrëveshja e Stabilizim Asocimit, neni 74 dhe 75, shërbejnë si një katalizator për zhvillimin dhe zbatimin e politikave të konkurrencës në përputhje me standardet dhe praktikatat evropiane.

Një mjedis konkurrues siguron se do të ketë hyrës potencial në “garë” për të prodhuar një produkt të ri apo për të ofruar një shërbim më të mirë. Si pasojë, konkurrenca e fuqishme përbën nxitësin kryesorë të rritjes së produktivitetit dhe siguron që tregu do të mbetet konkurrues.

*Nga një mjedis konkurrues i mirëfilltë jep mundësi të zgjedhjes, shërbime më të mira, cilësi, çmimet konkurruese dhe produktet të reja (inovacione).*

Aktet normative duhet t’i trajtojnë në mënyrë të barabartë ndërmarrjet (operatorët) në treg, trajtimi i ndryshëm duhet të bazohet në kriteret objektive.

Evitimi i favorizimit dhe krijimi i lehtësirave për ndërmarrjet e mëdha mundëson krijimit të ndërmarrjeve që zotërojnë fuqi tregu dhe pengon ndërmarrjet e tjera të jenë konkurruese në treg, e posaçërisht ato ndërmarrje që janë në të njëjtin nivel të operimit dhe ofrimit të shërbimeve.

**Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës vlerëson dhe konstaton se Vendimi Nr.579/2018, lëshuar nga Këshilli Drejtues i Odës së Avokatëve të Kosovës, datë 10.04.2018, bie ndesh me politikat dhe rregullat e konkurrencës, rrjedhimisht me Ligjin Nr.03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

Kërkesa merr epilogun si në dispozitiv të këtij Rekomandimi.

Me këtë Rekomandim, të njoftohet:

- Oda e Avokatëve
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës
- Arhiva

**KOMISIONI**  
**AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS**

  
Ahmet Krasniqi  
Zv. Kryetar

  
Valon Prestreshi  
Kryetar

  
Fatime Haziri  
Anëtare

  
Muhamed Krasniqi  
Anëtar

  
Shaqir Morina  
Anëtar

